



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 24-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 26.12.2019 (e enjte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 15. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 18. Labinot Aliaj, PDK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 19. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 20. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 21. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Riza Dreshaj, LDK; | 22. Agron Avdijaj, VV; |
| 9. Ruzhdi Metaj, LDK; | 23. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Valbona Demaj, LDK; | 24. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 25. Radenko Belošević, RB dhe |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 26. Slaviša Maliković, SM. |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | |
| 14. Misin Berisha, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Nënkryetari Agim Ademaj, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj, (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z.Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e 24-të të rregullt të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKSb-së;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për zëvendësimin e anëtarëve të KKSb-së;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE)
8. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, atëherë kush është që të miratohet ky rend i ditës për këtë mbledhje?

Kuvendi në mënyrë unanime, miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje, pa ndryshime.

Në procedurën e votimit nuk mori pjesë: Zenel Shatri, Haki Podrimaj dhe Radoš Repanović.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje mungon Radoš Repanović, SL. Gjithsej në mbledhje ishin të pranishëm 26 (njëzetë e gjashtë) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdon me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Zenel Shatri, Haki Podrimaj dhe Radoš Repanović.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha . Fjalën ja kaloi drejtorit Hysni Maxharri.

Hysni Maxharri, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi projekt-Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoha.

Naim Imeraj, përshëndeti të pranishmit. Pika 2.3 ka të bëjë me taksën për orar të shtuar për veprimtari zejtare, kisha lut drejtorin që të na sqaroj se cilat janë ato veprimtari zejtare? Nëse janë specifike kisha propozuar që të jetë tarifë më e ulët nëse lejon ligji.

Eljot Kukiqi, kam pyetje të neni 15, a janë veteranët e luftës të liruar nga këto pagesa?

Labinot Aliaj, përshëndeti të pranishmit. Te neni 10, Drejtoria për Shërbime Publike, pika 3 leja për bllokimin e rrugëve në urbanizëm, 3.1 thotë 20 euro për 12 orë ndërsa 3.2 është 25 euro për 24 orë. Ndryshimi prej 5 euro mendoj se çdo kush e bllokun rrugën për 24 orë me lehtë se 12 orë sepse edhe punën e përfundon më ngadalë. Është ndryshim i vogël vlera prej 5 euro. Edhe tek shëndetësia neni 9 pika 4, shfrytëzimi i ambulancës me kërkesë të klientit pa referim të mjekut e që nuk janë raste emergjente, relacioni Istog-Pejë thotë 10 euro ndërsa Istog-Prishtinë, 30 euro. Nëse dikush e merr ambulancën për të shkuar deri në Pejë dhe nuk është rast emergjent dhe pagesa 10 euro pa referim të mjekut, me duket së është shumë pak. Sepse ato 10 euro shkojnë naftë, ku janë shpenzimet tjera. Dëmet janë më të mëdha se sa vet pagesa.

Mujë Osmanaj, përshëndeti të pranishmit. Ne si drejtori nuk kemi kërkuar që të bëhet ndonjë ndryshim. Pagesa, taksa që u përmend, duke u nisur nga ajo që rastet emergjente i dërgojmë pa pagese por edhe rastet tjera që prapë janë qytetarë tanë dhe ne ju bëjmë një shërbim, janë raste që janë njerëz të paralizuar dhe që janë më nevojë. Janë sikur rastet emergjente por kanë nevojë të barten nga shtëpia.

Zenel Shatri, sa raste kanë qenë deri me tani për transport deri në Pejë dhe deri në Prishtinë? Po involvohem në këtë ngase është lami e imja. Nëse nuk ka indikacione dhe ka mundësi bartje më vetura tjera nuk kisha thënë që të jetë aq lirë. Sepse pastaj mund të bëhen kërkesa jo të arsyeshme ose duhet të bëhet një komision dhe të caktoj indikacionet. Nëse është e nevojshme të bëhet transporti të bëhet edhe pa pagesë, nëse ka indikacione mjekësore.

Hysni Maxharri, pata pyetje për shërbime publike pas meje e merr fjalën drejtori dhe përgjigjet dhe të zhvillimi ekonomik. Ngarkesë për zgjatje të orarit të punës, taksa për një orë punë të veprimtarisë zejtare (orëndreqës etj) nga 50 bëhet 5 euro kjo është e harmonizuar me Rregullore për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha. Edhe të pyetja e Eliotit, duke u bazuar në Ligj për Veteranët e Luftës, nuk parasheh që familjarët e veteranëve të kenë benificione të tjera.

Enver Rugova, përshëndeti të pranishmit. Tingëllon jo logjikshëm por konsiderojmë që nuk bllokohet gjithë rruga por vetëm një aks. Kompania lejohet që dy persona t'i ketë që të rregullojnë komunikacionin. Parashihet që asnjë kompani dhe asnjë firmë nuk e zgjatë orarin e punës për 5 euro sepse ka edhe punëtorët për t'i paguar.

Nënkryetari, ne kemi një Rregullore me propozimet tona përveç pjesës që është me Udhëzime Administrative dhe ligje e që nuk mund të ndryshohen. Për pjesën tjetër ju kisha lutur ta formuloni propozimin dhe e hedhim në votim, nëse merr votat në rregull, e bëjmë ndryshimin.

Zenel Shatri, unë përmenda dy zgjidhje ose të ngritët çmimi ose të hiqet. Të mbetet indikacioni mjekësor kryesorë, nëse ka indikacion të hiqet taksa. Nëse dëshironi ta leni klauzolën me pagesë, unë kisha propozua minimumi me qenë 100 euro, deri në Prishtinë, nëse nuk ka indikacione mjekësore.

Mujë Osmanaj, unë nuk po e mbrojë me fanatizëm këtë, vetëm po dua me sqaroi. Nuk po bëhet fjalë për më dërgu dikënd me dëshirë deri në Pejë mirëpo bëhet fjalë për dikë, që ka nevojë por nuk ka mundësi të shkojë deri atje. Dhe kjo nuk bëhet hajt se po enden disa ambulanca pa nevojë por vjen ai person, me dokumente që i ka që t'i bëhet një shërbim. Vjen në drejtori e paraqet me emër, mbiemër dhe i bëhet një shërbim gati është e njëjtte me atë që ne e dërgojmë pa pagesë prej QKMF-së. Ne as nuk po mundohem të fitojmë diçka por as nuk po humbim asgjë, konsiderojë që nuk ka nevojë me u ndryshu asgjë por ju jeni asamblastë dhe mundeni me bërë ndryshimin.

Selajdin Bytyçi, këto raste sigurisht evidentohen, a ki ndonjë informacion se sa raste kanë ndodhur në vitin 2019?

Mujë Osmanaj, jo këtu nuk kam, mandej mund t'i tregoj sepse janë të shënuara të gjitha, çdo person që kërkon vizita shtëpiake, janë të shënuara në drejtori, dhe drejtori i shqyrton ato e shikon arsyeshmërinë e asaj pune dhe i dalin në ndihmë.

Zenel Shatri, për hir që kemi të bëjmë me pacient, unë propozojë që të lirohen të gjithë, vetëm indikacionin mjekësor ta cakton mjeku. Pra mjeku e cakton nëse është e domosdoshme që mos të bëhen në Istog, le të bëhen në Pejë, nëse jo në Pejë atëherë

le të dërgon në Prishtinë. Kështu që unë i kisha liruuar të gjithë dhe drejtori le t'i autorizoj mjekët që ta caktojnë indikacionin nëse është e nevojshme, të shkojë.

Mujë Osmanaj, ne nuk kemi kërkesë vetëm me dërgu por edhe me marrë, shembull është një pacient në Pejë, në gjendje të rëndë dhe bëjnë kërkesë me shku me marrë sepse sipas mjekëve nuk ka jetë tash ne duhet të shkojmë ta marrim.

Labinot Alijaj, unë po e mbrojë këtë që e thash, sepse ne i kemi vetëm pesë ambulanca dhe pesë raste me i pas po bllokohet. Unë jam për me i ndryshu tarifat, unë propozoj që Istog-Pejë, pagesa 30 euro , Istog-Prishtinë, pagesa 80 euro.

Agron Avidjaj, po me doket që as ne, as drejtorja nuk jemi të pajisur me informacione për me marr vendim a me rrit a me ulë tarifën. Meqenëse nuk i kemi këto informacione sepse edhe kur të caktohet tarifa duhet me pas një statistikë të rasteve se sa shpesh ke dërgu, çfarë rasteve janë, sa po ndodhin? Për të ditur me përcaktu këtë tarif. Meqenëse këto nuk i kemi, propozimi im është që mos me zgjatë shumë dhe ndoshta herën tjetër kur të vijmë të përgatitur për këtë propozim. Se ka raste sociale në gjendje emergjente e ndoshta i ka 10 euro, por 30 e ka problem me i siguru edhe ekipi i ekspertëve mjekësor duhet me ditë kënd ka me referu, unë jam që me vazhdu ashtu si është.

Naim Imeraj, duke mos dashur të konsistojë kontributin e kolegëve anëtar të këtij kuvendi komunal, unë si po e kuptoj kjo çështje ka të bëjë më një kompetencë të drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi. Ka të bëjë më sistemin shëndetësor nëse nuk është ashtu atëherë ma konfirmon ose demanton drejtori. Kjo ka qenë edhe më herët, tani nëse i marrim me prapaskena edhe nuk kisha dashtë me kriju prapaskena se kush ka qenë drejtor, kush nuk ka qenë por çështja e kompetencës. Nëse kryetari i komunës i ka dhënë kompetencë drejtorit të shëndetësisë, cili do qoftë ai për të dhënë subvencione, unë besoj se nuk është larg atij koncepti që drejtori i shëndetësisë në raste që i vlerëson dhe mbetet në ndërgjegjen e tij vlerësimi, të mundësoj këtë shërbim specifik. Unë kështu po e kuptoj, nuk ka të bëjë më Qendër të Mjekësisë Familjare dhe nuk ka të bëjë më sistemin shëndetësor, ka të bëjë me nevojtarët për atë shërbim. E që mund të jetë në periudha të ndryshme dhe mund të jetë në rrethana të ndryshme. Nëse qëndron kjo tezë që po e shtroj unë atëherë nuk besoj që është dashtë me e hjek këtë, se na paraqiten raste të cilat munden me qenë ose shumë të rënda, e është vullneti i vozitësit me dërguar por dikush duhet t'i thotë dërgo. Duhet ta merr një urdhër nga dikush, nëse është kjo atëherë nuk jam për të lëvizë. Mund të diskutojmë për nivelet por prapë po e trajtoj atë si një lloj subvencionit për nevojtarin.

Arben Kabashi, përshëndeti të pranishmit. Kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë Arsimit. Përderisa e kemi Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha atëherë sa kam parë, vërejtur dhe sa kam informacion, në gjimnaz mbledhen të holla nga nxënësit për sigurim atij objekti. A kanë të drejtë t'i mbledhin këto të holla edhe pse

në rregullore nuk është ajo shumë? Sa kam informacion 5 euro mbledhen në vit për të paguar sigurimin e shkollës. Sa i përket rastit në shëndetësi kisha kërku që të mbetet njëjtë.

Hajrush Shoshi, përshëndeti të pranishmit, sa i përket pyetjes së Arbenit, e kemi sqaruar disa herë në këtë sallë të kuvendit. Nuk është taksë por është Vendim i këshillit drejtues të shkollës për sigurimin e objektit shkollor, është më udhëzim administrativ.

Labinot Aliaj, kërkoj falje vetëm po e heku propozimin tim dhe po e mbështeti propozimin e doktorrit.

Kryesuesi, dy propozime janë a doni me hjek a me lanë?

Zenel Shatri, një propozim që jepet mund edhe të hiqet. Duke marrur parasysh që shumë shpejt na ka rënë të gjithëve për të vendosur, unë besoj që do të bëhet shpejt edhe Ligji për sigurime shëndetësore dhe rregullohet ashtu. Unë po tërhiqem nga propozimi dhe mendoj të vazhdoj të jetë ashtu siç ka qenë.

Kuvendi me 22 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime miratoi projekt-Rregulloren komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Arif Elshani, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKSB-së. E keni pasur në material dhe i keni edhe rekomandimet e KPF-së lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ja kaloi Nënkryetarit.

Nënkryetari, ju e dini së KKSB-ja është trup i këtij kuvendi dhe çdo vit punon në bazë të planit të punës, i cili aprovohet në kuvend. Për vitin 2020 KKSB-ja ka hartuar planin e punës dhe e ka aprovuar në mbledhjen e mbajtur të KKSB-së dhe e keni para vetes këtë plan. Nëse keni diçka rreth këtij plani urdhëroni.

Agron Avdijaj, kam pyetje. Përmes organizimit të KKSB-së është mbajtur një workshop në Klinë ku kanë qenë të ftuar të gjitha komunat por nga komuna e Istogut nuk ka marrë pjesë askush, pse?

Nënkryetari, kordinator i KKSB-së është Skender Hasangjekaj dhe ai ka lënduar këmben dhe nuk ka mundur të marrë pjesë.

Arben Kabashi, kërkoj një raport të detajuar të KKSB-së dhe të dëgjojmë se çfarë vendimesh kanë marr. Në Gjurakoc kanë filluar dy objekte.

Kryesuesi, ne këtu e kemi planin e punës së KKSBS-së, i cili duhet të aprovohet. Raporti i punës do të vijë sigurisht në janar dhe mund të marresh përgjigje.

Nënkryetari, nuk kam diçka për të shtuar përveç, kërkoj prej asamblistëve që thash edhe në fillim është trup e juaja dhe me mund me kuptu rolin e këtij këshilli çka është ky. Do të thotë ky nuk merr vendime, ky shqyrton tema, e keni pa përafërsisht temat që janë në rendin e ditës? Sugjeron, ka kontakte me ekspert, ministri, i fton, japin sqarime. Raporti i punës paraqitet në afate të rregullta sigurisht në Janar do të jetë raporti i punës së KKSBS-së. Tani po flasim për planin e punës që ne duhet të startojmë në Janar me plan të punës të këtij këshilli. Temat të cilat shqyrtohen në të, unë thash fillimisht nëse keni diçka rreth temave për të shtuar ndonjë gjë ose për të munguar është e drejt e juaja, raporti i punës është diçka tjetër. Për çdo vit e kemi raportin e punës të KKSBS-së, është një organ i mirë, një trup e mirë, që punon dhe funksionon mirë dhe në raport të punës i shohim nëse ka vërejtje apo e shohim se çfarë është punuar për atë periudhë.

Kryesuesi, KKSBS-ja do ta sjell raportin e punës dhe në raste të caktuara sjell edhe sugjerimet dhe rekomandimet për kuvendin, nëse ka dikush për pikat e rendit të ditës që mendoni të parashihen në planin e KKSBS-së mund të propozoni. Edhe pse ky plan i punës ka kaluar dhe është aprovuar nga KKSBS por është obligim ta miratojmë edhe në kuvend. Në KPF është rekomanduar një pikë e rendit të ditës dhe të jetë në planin e punës së KKSBS-së dhe unë pyes anëtarët e kuvendit, a jeni për që të aprovohet kjo pikë? Që në muajin Qershor të shtohet si pikë për diskutim, rrënim i objekteve të vjetra në Istog. Pasi në mënyrë unanime aprovohet kjo pikë, meqë nuk ka pyetje më, pyes anëtarët e kuvendit se kush është që të miratohet Plani i Punës së KKSBS-së me pikën shtesë?

Kuvendi me 21 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime miratoi i Planin vjetor të punës së KKSBS-së për vitin 2020 me pikën shtesë të rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Nexhmedin Balaj, Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Arif Elshani, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për zëvendësimin e anëtarëve të KKSBS-së.

Nënkryetari, janë vende vakante në KKSBS, Kryesuesi i Këshillit të prindërve vjen automatikisht në KKSBS dhe këto procedura i ka zhvilluar Drejtorati i Arsimit, me këshillat e prindërve në të gjitha shkollat në komunën e Istogut. Është zgjedhur Robert Gegaj kryetar i këshillit të prindërve dhe ai do të jetë automatikisht anëtarë i KKSBS-së andaj propozimi i Kryetarit të komunës është që Robert Gegaj të jetë

anëtarë i KKSB-së dhe e dyta është përfaqësuesja e komiteti boshnjak që ka munguar në mbledhje të këtij këshilli dhe komiteti boshnjak është dakorduar që Enisa Ćorović të hjeket dhe Ćula Karišik, të jetë anëtare e këtij këshilli të KKSB-së në nivel komunal. Është propozim-vendim i kryetarit që këta dy emra të kalojnë është procedura ligjore e tillë që të kalohet përmes asambleje që këshilli të plotësohet me këta dy emra.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi propozim-vendimin 01Nr.1040/2019, të datës 19.12.2019, të Kryetarit të komunës, që vend të znj. Zizë Bujupaj, caktohet z. Robert Gegaj, Kryesues i Këshillit të prindërve, të jetë anëtar i KKSB-së.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Nexhmedin Balaj, Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Arif Elshani, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi propozim-vendimin 01Nr.1040/2019, të datës 19.12.201, të Kryetarit të komunës, që vend të znj. Enisa Ćorović caktohet znj. Ćula Karišik, përfaqësuese e komunitetit boshnjak, të jetë anëtare e KKSB-së.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Nexhmedin Balaj, Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Arif Elshani, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme, lidhur me këtë pikë, i kemi tri propozim-vendime të kryetarit të komunës, bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, afatgjatë të pronave komunale dhe këmbimit të pronave.

Nënkryetari, kemi të bëjmë me dy ndërrime të pronave për interes të rrugës publike, në të dy rastet dhe unë e ftoj drejtorin që t'i sqaroj teknikisht ku ndodhen këto prona dhe procedurat që janë zhvilluar.

Jashar Blakaj, përshëndeti të pranishmit dhe sqaroj se ku gjinden këto parcela përmes sllajdeve. Janë dy raste të pronës së paluajtshme, të Herolinda Osmanaj arsyjeja pse janë dy vendime është për shkak se janë dy parcela, njësitet e terrenit i kanë bërë matjet. Prona e cila këmbëhet, ministria përkatëse e bën vlerësimin, rruga të burimi është një parcele komunale dhe propozohet të këmbëhet për rastin e parë. Për rastin e parë janë dy vendime edhe pronari është i njëjtë. Rasti tjetër ka të bëjë me Bajram Blakaj, vendimi është, matjet gjeodezike janë bërë në vitin 2016. Që ta keni më të qartë ku është rruga e shikoni në sllajde, është rruga të burimi dhe këtu është një pronë që propozohet për këmbim.

Naim Imeraj, kisha kërkuar nga drejtori, që të sqarohen edhe pse u pa në foto edhe në projektimin e skicës kadastrale që ato rrugë janë rrugë ekzistuese të më hershme. Njëra rrugë përfundon mbi shtëpinë time e tjetra mbi shkollë dhe të varrezat e ortodoksëve. Vetëm është çështja me zgjerimin e atyre rrugëve nuk kanë qenë fare parcelizuese ato rrugë apo me zgjerimin e atyre rrugëve është krijuar hapësirë me e madhe me hy në kategorinë e rrugës sepse duhet të ketë një hapësirë të caktuar, kjo të sqarohet.

Jashar Blakaj, janë rrugë të parapara më plan rregullues. Harrova me cek është paraparë më plan rregullues dhe është komplet pronë private. Ndërsa te rasti i dytë, pjesa e rrugës te Kongresi i Manastirit, kjo rrugë që dy vite është asfaltuar mirëpo kjo pjesë ka mbetur pa u asfaltuar për shkak se është komplet në pronë private.

Naim Imeraj, edhe një sqarim, parcelat që po propozohen nuk janë të planifikuara në interesin komunal? Dhe në planifikimet komunale nuk është planifikuar të ketë destinim të veçantë?

Jashar Blakaj, janë ngastra kadastrale me plan rregullues, mirëpo ajo ngastër është pronë komunale. Ndërsa në pjesën të "Morea" ajo është pronë komunale që me plan rregullues është ndërtim.

Labinot Aliaj, pyes drejtorin diku 712 m² po ja marim znj. Herolinda ndërsa ne si komune po ja japim 630 m²?

Jashar Blakaj, po ashtu është, ekziston mundësia që Ministria përmes komisionit të vet thotë se duhet të kompensohet edhe më shumë. Zyrtari ligjor duhet ta ketë parasysh së është tokë ndërtimore, problemi është se pronë komunale nuk kemi. Këto kanë qenë dy mundësitë edhe kërkesat e palëve. Edhe palët kanë të drejtë me propozu dhe me u pajtu.

Kryesuesi, pyes anëtarët e kuvendit a dëshiron fjalën? Nëse jo atëherë po vendosim për propozim-vendime.

Kuvendi me votim 22 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.989/19, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë të paluajtshme të personit fizik, Herolinda (Avdullah) Osmanaj.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Kuvendi me votim 22 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.995/19, të datës 12.12.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën të paluajtshme të personit fizik, Herolinda (Avdullah) Osmanaj.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.988/19, të datës 12.12.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të personit fizik, Bajram (Ahmet) Blakaj.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Lavdiye Bujupi, Arif Elshani, Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon me pikën e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE). Fjalën ia kaloi Isa Hoxhaj.

Isa Hoxhaj, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE).

Naim Imeraj, falënderon për fjalën. Çka është interesant të dimë ne si miratues të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) është se ky plan ka të bëjë me pronën publike, nuk ka të bëjë me individ. Kjo është esenca e Ligjit mbi Eficiencë të Energjisë, duke parë faktin se lamia është aq e gjerë me ndiku në kualitetin e jetës, më se pari duhet me ja fillu të ata që kanë forcën e mundësinë me ndërru në drejtim të efqiencies së energjisë e pastaj me dhëne mundësi qoftë përmes financimeve dhe mundësive tjera edhe tek individ. Ne këtë draft e tha se përcaktohen: obligimet, caqet dhe masat. Sa i përket caqeve përcaktohen në tri fusha: në fushën e ndërtesave, fushën e investimit publik dhe në fushën e flotës së automjeteve komunale e cila nuk është trajtuar në tërësi ndërsa dy fushat tjera janë trajtuar shumë mirë. Ashtu siç tha edhe zyrtari kish mund me vlerësu së është një plan i punuar mirë, me materie të shkoqitur mirë, me elemente analitike, vlerësuese dhe projektuese për të ardhmen, të qëndrueshme. Ajo çka na intereson ne si kuvend i komunës është çështja, se si do t'ia arrimë ato caqe dhe cilat janë implikimet buxhetore. Në aspektin e ndërtesave administrative është konstatuar, që prej 56 ndërtesave të evidentuara si pronë komunale, 44 prej tyre nuk e përmbushin normën e shpenzimit, e cila përcaktohet në nivelet: kilovat, orë për metër katror në vit. Edhe si të tilla me implikime janë përcaktuar si prioritare, që të intervenohet me buxhet investues prej 400 mijë euro. Tani janë dy vjet që shpresoj ta kemi parasysh të projektimet buxhetore që sa më shumë, që të jetë e mundur të planifikojmë mjete financiare në drejtim të përmbushjes së këtij planit të veprimit. Sa i përket dëgjimit publik konstatohet se prej përafërsisht 500 trupa ndriçues që janë aktiv në komunën e Istogut, të ndriçimit publik 24%, prej tyre janë me poqa mbi bazën e natriumit, që janë jo shumë eficient edhe relativisht ndotës për ambientin.

Kuvendi me 22 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime miratoi Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE).
Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Riza Dreshaj, Haki Podrimaj, Arif Elshani, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e kuvendit komunal. Pyetje me shkrim nuk kemi, fjalën e ka kërkuar.

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit, unë e kam një pyetje por nuk e di kush është kompetent, çfarë ndodhi me një propozim timin që e pata propozuar që bizneset private, ditën e diele ta kenë ditë pushimi? Përmes disa mediave po dëgjohet se faktikisht duhet në kuadër të regjionit, që dita e diele të jetë ditë pushimi përjashtim me ato kriteret që i kemi citu në rregullore? Pyetja e dytë është, e pata debatuar edhe më herët për tre hapeshin në shkollë, çfarë ndodhi me fatin e tre hapeshit në stazën, atje të shkolla jonë? Është ndërtuar tre hapeshi por nuk është ndërtuar me standarde, e tash nuk ekziston fare.

Agron Avdijaj, atëherë unë i kam dy pyetje njëra shkon për drejtorin e shëndetësisë, çështja është lidhur me funksionimin e pediatriisë në komunën e Istogut. Siç duket është duke u bërë diçka renovim mirëpo qytetarët po hasin në vështirësi, sa i përket kësaj ish dashtë drejtori me na e sqaru se qysh është gjendja, natyrisht e patëm erën që na fryu tash shpejt edhe janë shkaktuar disa dëme. Desha të dijë a është bërë ndonjë vlerësim edhe nëse është bërë, qysh është gjendja a ka pas të lënduar në atë kuptimin e njerëzve edhe në aspektin material? Duke e ditur që Istogu e ka këtë problematik vazhdimisht, a keni zhvilli ndonjë komunikim apo ndonjë kërkesë pak ma serioze në nivelin qendror, që të hapet një fond apo të bëhet diçka më e veçantë, të parashikuara për komunën e Istogut, sidomos për fatkeqësitë që po na ndodhin si rezultat i erës që na u ka bërë, që po e dimë, që ka me na shkaktuar dëme, e kur e dimë paraprakisht është mirë me marr masa serioze.

Misin Berisha, unë kam pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, dy projekte që janë duke u punuar në Staradran, trotuari dhe ndriçimi publik, shkurtimisht më tregu planin, domethënë çfarë projekti është dhe deri ku ka mbërri puna?

Labinot Aliaj, përshëndeti të pranishmit, unë më shumë po kërkoj një sqarim prej drejtorit të Arsimit, në lidhje me komisionin që është formuar për shqyrtimin e ankesave për bursa. Pyetja ime është, komisioni a kanë me u bazu vetëm në bazë të rregullores që thotë kthim përgjigje për ata që janë ankuar apo ka drejt edhe me shqyrtu dokumente mbas asaj që ne e kemi vlerësuar si komision për ndarje të bursave?

Hajrush Shoshi, Ashja e patë fjalën për fushën e tenisit, e cila është duke u ndërtuar në oborrin e shkollës së gjimnazit. Aty ka qenë një shteg për tre hapësh, ka qenë i planifikuar në vitin e kaluar mirëpo nëse e lejojmë ndërtimin e atij shtegu, atëherë

ajo pjesë mbetke pasive. Kështu që për 400-500 euro nëse nuk e bënim fushën e tenisit me shfrytëzu atë pjesë për mos me zënë pjesën tjetër të oborrit, mu ka dukur më e arsyeshme kështu që besoj që është shumë me vend që është prish ai tre hapësh dhe do të ndërtohet prapë.

Ajshe Metaj, ai stazh i tre hapeshit ka qenë i ndërtuar pa standarde, ka qenë i ndërtuar me pllaka, më mirë që është prishur, pa u shfrytëzuar asnjëherë, se sa me thy kokën fëmijët, që vrapojnë andej. Unë veç desha me përgëzu drejtorin, më mirë që është prish, se sa me pësu dikush.

Mujë Osmanaj, fillimisht për juve që ju intereson se si funksionojnë repartet apo shëndetësia primare, ju kisha lut që ta merrni statusin, i cili është miratuar në këtë asamble në vitin 2016. Në të gjitha shërbimet në QKMF janë kompetent mjekët familjarë, specialistët, pediatër, internist etj. Me ligj me status të shëndetësisë primare e kemi për obligim me i dërgu deri në pension, kur të pensionohet nuk kemi drejtë me kërku internist me këtë ligj që është tani, ligji që vjen është pak më ndryshe sipas informacioneve. Agron, punohet 24 orë aty, janë dy mjekë paradite deri në ora 15:00 i bashkëngjitet edhe një mjek, dy mjekë të tjerë janë deri në ora 22:00. Faktikisht njëri është në ambullantë poshtë që e kemi pa marrë verës për shkak se me i ndarë pak mos të bëhet tollovi e madhe dhe me pas vend. Tani është vendi i përshtatshëm dhe në të ardhmën munden me kalu dy mjekë deri në ora 23:00, në një të ardhme jo shumë të largët që kishte me qenë mirë një mjek gjithë natën, për teknik së paku janë dy gjatë gjithë kohës 24 orë. Tani do e kemi edhe një problem sepse gjinekologu del në pension dhe ne nuk mundë të hapim konkurs sepse nuk na lejohet. Jemi duke i shikuar ato mundësit 3 muaj apo 6 muaj dhe ne e kemi në specializim një gjinekologe dhe presim me ligjin e ri me qenë në favor të saj, që sigurisht duhet me qenë në të ardhmën edhe një pediatër, që të funksionoj aty afër.

Zenel Shatri, unë kam dhënë një propozim që të punojnë dy mjek 24 orë, të jetë njeri specialist familjar dhe tjetri i prekësës së përgjithshme. I din dy tri raste që kanë ndodh dhe nuk dua të i laboroj këtu për arsye se ka qenë kujdestar mjeku, i cili ka fillu dje me punu. Çka ke vepru në këtë aspekt? A ekziston mundësia me i bërë dy mjekë, një specialist dhe një mjek të prekësës së përgjithshme sikur janë në komuna tjera. Nëse keni mungesë të kuadrit, pranoni të tjerë.

Mujë Osmanaj, janë punësuar vazhdimisht. Mementalisht nuk ka të papunësuar.

Zenel Shatri, gabim jeni se ka të papunësuar, po me vjen keq por djali im është i pa punë, pastaj djali i Haki Zenelit, djali i Hamdi Blakes etj. A ki mundësi pas orës 22:00 me qenë një specialist në kujdestari?

Mujë Osmanaj, nuk janë lajmëruar tek ne, po ashtu vendet janë të limituara. Ke mundësi që të vish edhe tek unë dhe bisedojmë. Shëndetësia është shumë mirë, janë përfunduar shumë projekte dhe po pranojmë mjekë dhe infermier.

Naim Imeraj, dua të kyçëm me një konstatim. Tash një muaj na vjen edhe raporti i punës së kryetarit. Aty mundemi të hapim më shumë debat dhe respekt për të dy kolegët.

Enver Rugova, kam pyetje nga Agron Avdijaj ndërsa pyetjes Misin Berishës, do t'i përgjigjem zyrtarisht dhe ja dërgoj komplet. Për pyetjen e Agronit, kemi dëme më së shumti në rrjetin energjetik dhe ende kemi probleme. Dëme evidente kemi në Dushkajë, sa i përket kompensimit. Duhet me shiku, si janë ndërtuar këto kulme edhe nuk mundemi të jemi kujdestar, se po ka postime në rrjete sociale, jo duhet të intervenojë ministria. Nuk duhet të intervenojë ministria por komuna, kemi kontratën dhe e bëjmë raportet komisionet edhe unë kam qenë në teren gjithë ditën. Drejtoria i ka të dhënat dhe kush është që duhet të kompensohet, do të kompensohet.

Nënkryetari, pasi është fundi i vitit unë desha të ju falënderoj dhe të ju uroj edhe në emër të kryetarit për bashkëpunimin dhe punën e mirë, që e kemi bërë këtë vit. Ju falënderoj dhe ju uroj një vit të mirë për ju dhe familjet e juaja.

Kryesuesi, edhe unë dëshiroj të ju falënderoj për bashkëpunimin dhe punën e bërë gjatë këtij viti, urime Viti i Ri 2020 dhe duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim dhe kontributin e dhënë i shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në orën 12:00.

Procesmbajtëse,
Arlinda Kurtaj



Kryesues,
Z. Qaush Balaj

